


## Ndryshimet në legjislacion

Gusht 2017

### Në këtë publikim:

- Marrëveshja për shmangien e tatimit të dyfishtë për Tatimet në të Ardhura dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal dhe Shmangien Tatimore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane;
- Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;
- Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 07/2017 Lidhur me Nivelin e Rezervave të Lëndëve Djegëse për Prodhuesit e Energjisë Elektrike;



### 1. Marrëveshja për shmangien e tatimit të dyfishtë për Tatimet në të Ardhura dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal dhe Shmangien Tatimore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane

Kjo Marrëveshje është lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane (Shtetet Kontraktuese).

Marrëveshja është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 17 gusht 2017 dhe do të hyj në fuqi në datën në të cilën do të pranohet njoftimi për përfundimin e procedurave që kërkohen me ligj për hyrjen e kësaj marrëveshje në fuqi.

Marrëveshja zbatohet për personat të cilët janë rezidentë të një ose të Dy Shteteve Kontraktuese, ndërsa qëllimi i saj është shmangia e tatimit të dyfishtë për tatimet në të ardhura, pa krijuar mundësi për mos-tatim apo tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit apo shmangies.

Marrëveshja do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që vendosen në emër të një Shteti Kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën mblidhen.

Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet kjo marrëveshje janë në veçanti:

- Në Zvicër: tatimet federale, kantonale dhe komunale mbi të ardhurat (të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat e fituara, të ardhurat nga kapitali, fitimet industrial dhe tregtare, fitime nga kapitali, dhe zëra të tjerë të të ardhurave);
- Në Kosovë: tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi të ardhurat e korporatave.

Marrëveshja do të zbatohet edhe ndaj çdo tatimi identik ose thelbësisht të ngjashëm, i cili është vendosur pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, si shtesë apo në vend të tatimeve ekzistuese.

Marrëveshja nuk do të zbatohet për tatimet e mbajtura në burim për fitimet në lotari.

Të ardhurat që realizohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që gjenden në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër kontraktues.

Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje.

Fitimet nga operimi i anijeve ose aeroplanëve në trafikun ndërkombëtar do të jenë të tatuashme vetëm në Shtetin Kontraktues ku është i vendosur vendi i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes.

Dividendët e paguara nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

Interesi që krijohet në një Shtet kontraktues dhe është në pronësi përfutuese të një rezidenti të një Shteti tjetër Kontraktues mund të taten vetëm në atë Shtet tjetër.

Të drejtat pronësore që krijohen në një Shtet kontraktues dhe janë në pronësi përfutuese të një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues do të taten vetëm në atë Shtet tjetër.

Mëditjet, pagat dhe pagesat e tjera të ngjashme që përfitojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të taten vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

Shërbimet e drejtorëve dhe pagesat e tjera të ngjashme që përfitojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një kompanie, e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

Pensionet dhe të ardhurat e tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti kontraktues

lidhur me punësimin në të kaluarën do të taten vetëm në atë Shtet. Megjithatë kur pensionet e tilla dhe të ardhurat e tjera të ngjashme që krijohen në Shtetin tjetër Kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit në Shtetin e përmendur në fillim, ky Shtet tjetër kontraktues mund t'i tatojë të ardhurat e tilla.

Rrogat, mëditjet dhe të ardhurat e tjera të ngjashme, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose një ndërmarrje politike, ose autoritet lokal, ose një individ, në lidhje me shërbimet e kryera në atë shtet ose nënndarje, ose autoritet, to të taten vetëm në atë shtet.

Në rastin e Zvicrës, tatimi i dyfishtë do të shmanget kur:

- një rezident i Zvicrës realizon të ardhura të cilat në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, mund të taten në Kosovë, Zvicra do të lirojë të ardhurat e tilla nga tatimi, por për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, mund të aplikojë normën e tatimit e cila do të kishte me qenë e aplikueshme, nëse të ardhurat e përjashtuara nuk do të ishin përjashtuar në atë mënyrë.

Në rastin e Kosovës, tatimi i dyfishtë do të shmanget kur:

- një rezident i Kosovës realizon të ardhura të cilat në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të taten në Zvicër, Kosova do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në Zvicër.

Kjo zbritje nuk duhet të tejkalojë atë pjesë të tatimit të Kosovës, të llogaritur para zbritjes së dhënë, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave që mund të taten në Zvicër.

Kur një person konsideron se veprimet e një apo të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë për të në tatim që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të cilitdo prej shteteve kontraktuese brenda tri viteve nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi deri në ndërprerjen e saj nga njëri Shtet Kontraktues.

Cilido Shtet Kontraktues mund t'i jap fund Marrëveshjes nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke njoftuar tjetrin me shkrim, të paktën gjashtë muaj para çdo viti kalendarik.

## **2. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme**

Ky Udhëzimi Administrativ është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 08.08.2017 dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i llojeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike, centralet që do të mbështeten për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme për prodhim të energjisë, kushtet e përdorimit dhe standardet teknike, promovimin e skemës mbështetëse dhe masat për bashkëpunim siç janë: transferi statistikor, skemat e përbashkëta mbështetëse, dhe projektet e përbashkëta për plotësimin e caceve të burimeve të ripërtërishme.

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjitha institucionet kompetente dhe ndërmarrjet e energjisë që promovojnë shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Udhëzimi Administrativ kategorizon centralet që shfrytëzojnë burimet e ripërtërishme për prodhimin të energjisë elektrike dhe asaj termike. Pajisjet dhe sistemet e centraleve të caktuara për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme duhet t'i përmbushin kërkesat e standardeve teknike të cilësisë, të cilat janë përcaktuar në Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ.

Udhëzimi Administrativ përcakton poashtu skemat mbështetëse për promovimin e energjisë elektrike dhe asaj termike nga burimet e ripërtërishme, programet trajnuese për instaluesit e pajisjeve për stabiliment që shfrytëzojnë biomasë, pompa termike, instalime të cekëta gjeotermike, kolektorëve diellor për energji termike, kolektorëve diellor për energji termike dhe pajisjeve fotovoltaike, pjesëmarrjen në programet trajnuese, certifikimin e tyre dhe auditimet e jashtme.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 për shfrytëzimin dhe

mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

## **3. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 07/2017 Lidhur me Nivelin e Rezervave të Lëndëve Djegëse për Prodhuesit e Energjisë Elektrike**

Ky Udhëzim Administrativ është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 08.08.2017 dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.

Udhëzimi Administrativ ka për qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelin e rezervave të lëndëve djegëse që duhet të mbajnë prodhuesit e energjisë elektrike si masë për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ përcaktojnë detyrimin e prodhuesve të energjisë elektrike lidhur me llojin dhe sasinë e rezervave të lëndëve djegëse.

Ndërmarrjet e energjisë elektrike të licencuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që shfrytëzojnë lëndë djegëse primare dhe mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike, obligohen të mbajnë lëndë djegëse rezervë të nevojshme për të siguruar prodhim të pandërprerë me energji elektrike gjatë vitit:

- lëndën primare linjit , për një periudhë të paktën për pesëmbëdhjetë (15) ditë;
- lëndën djegëse mbështetëse naftë, për një periudhë të paktën për një (1) muaj;
- lëndën djegëse mbështetëse mazut për një periudhë të paktën për dy (2) muaj.

Inspektorati i Energjisë bën mbikëqyrjen administrative të zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ. Ndërsa, nëse ndërmarrjet e energjisë elektrike nuk i zbatojnë dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, Inspektorati i Energjisë:

- urdhëron heqjen e parregullsive të vërejtura dhe caktimin e afatit për eliminimin e tyre, dhe
- nëse ndërmarrja e energjisë elektrike nuk vepron sipas paragrafit dispozitave të këtij udhëzimi administrativ Inspektorati i Energjisë i propozon Rregullatorit shqiptimin e gjobës administrative sipas

dispozitave të përcaktuara në legjislacionin  
në fuqi.

## **Kontaktet e Deloitte:**

### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore dhe  
Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 590 807

Email: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 780 769

Email: [lplakollikasumi@deloittece.com](mailto:lplakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në saje të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.